




KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**RAPORT I NDËRMJETËM MONITORIMI
“MBI NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E AKTORËVE
PËRGJEGJËS TË OFRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE
PARËSORE”**



Ky Raport përfshin periudhën Janar – Maj 2020 dhe është shtrirë në qytetet Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Elbasan



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

**RAPORT I NDËRMJETËM MONITORIMI
“MBI NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E AKTORËVE PËRGJEGJËS
TË OFRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE”**

Ky Raport përfshin periudhën Janar – Maj 2020 dhe është shtrirë në qytetet Tiranë,
Shkodër, Durrës dhe Elbasan

Maj 2020

Ky studim u realizua në kuadër të projektit “Garantimi i mirëfunksionimit të sistemit të ofrimit të ndihmës juridike parësore, nëpërmjet monitorimit të ngritjes dhe veprimtarisë së mekanizmave përgjegjës”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA). Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e Fondacionit



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Punoi:

Znj. Iva Plaushku, Eksperte

Rishikoi:

Znj. Ardita Kolmarku – Juriste/Koordinatore e projektit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor:

©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “TeknoProjekt”

Shk. 2, Ap. 10, Tirana – Albania

Kutia Postare nr. 1752

Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al

PËRMBAJTJA E RAPORTIT:

LISTA E SHKURTIMEVE.....	4
Përmbledhje ekzekutive	5
1. Ngritja dhe funksionimi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas	8
1.1. Aksesueshmëria dhe kushtet infrastrukturore dhe logjistike të saj.....	8
1.2. Struktura organizative, procedurat e emërimit dhe vakancat e konstatuara.....	9
1.3. Aktivitetet ndërgjegjëse të realizuara nga ana e kësaj Drejtorie	9
2. Organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore	10
2.1. Aksesueshmëria dhe stafi.....	10
2.2. Mënyra e financimit të tyre.....	11
2.3. Marrëdhënia me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas	12
2.4. Ngritja e qendrave për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore	14
2.5. Zyra e Ndihmës Ligjore Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë.....	15
3. Klinikat e Ligjit të ngritura dhe të mbështetura financiarisht nga OSFA.....	15
3.1. Aksesueshmëria dhe stafi.....	15
3.2. Marrëdhënia me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas	16
3.2.1. Paqartësi, mendime dhe sugjerime mbi Draft-Marrëveshjen e adresuar	16
3.3. Problematikat e Klinikave të Ligjit në universitete	16
4 Sfidat e krijuara nga situata Covid-19	18
Rekomandime:.....	19

LISTA E SHKURTIMEVE

Ligji nr.111/2017 "Për Ndhimën Juridike të garantuar nga Shteti"- **Ligji nr.111/2017**

Ministria e Drejtësisë - **MD**

Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas – **DNJF**

Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” – **OSFA**

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – **UNDP/PNUD (Albania)**

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare – **QNLQ**

Organizata Shërbimi Ligjor Falas - **TLAS**

Këshilli i Ministrave - **KM**

Organizatat jo-fitimprurëse - **OJF**

Institucionet e Arsimit të Lartë - **IAL**

Vendim i Këshillit të Ministrave - **VKM**

Përmbledhje ekzekutive

Miratimi i ligjit nr. 111/2017 “Për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, ndër të tjera synonte përbushjen e një sërë qëllimesh, ku ndër më të rëndësishmit është ai për krijimin e një sistemi për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë.

Që në fazat e para të zbatimit të këtij legjislacioni, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka monitoruar skemën e ofrimit të ndihmës juridike dytësore¹ dhe atë parësore². Përgjatë këtij monitorimi, KShH ka evidentuar vonesat në zbatimin e legjislacionit, të nxjerrjes së akteve nënligjore, të ngritjes së strukturave përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e skemës së ndihmës juridike falas, të plotësimit me personel të këtyre strukturave, të pajisjes me infrastrukturën e nevojshme, të realizimit të memorandumëve të bashkëpunimit midis institucioneve apo edhe enteve publike e private etj. Të gjitha këto vonesa kanë ndikuar në aksesin e munguar apo të vonuar të qytetarëve në organet e drejtësisë si dhe kanë krijuar vështirësi për organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime ligjore falas për qytetarët, një pjesë e të cilave e kanë realizuar këtë shërbim mbi baza vullnetare dhe pa mbështetje financiare.

Në vazhden e këtyre misionëve monitoruese dhe rekomandimeve periodike të adresuara institucioneve përgjegjëse, KShH e vëren si domosdoshmëri ushtrimin e **presionit pozitiv** ndaj aktorëve pjesë e zinxhirit të ofrimit të ndihmës juridike parësore, me qëllim mirëfunksionimin e këtij sistemi.

Ndër risitë e reflektuara në ligjin nr. 111/2017 përfshihet kategorizimi i subjekteve përfituese nga skema e ndihmës juridike parësore, konkretisht shtetasit me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, dhe ato që pavarësisht disponimit të të ardhurave dhe pasurisë janë pjesë e kategorive vulnerabël.³ Në fokus të këtij procesi monitorimi i cili u shtri në 4 qytete të vendit, përkatësisht në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër, ishte ngritja dhe funksionimi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, Qendrave të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve publike dhe organizatat jofitimprurëse, të cilat në fokus të veprimtarisë së tyre kanë ofrimin e shërbimeve ligjore.

Në aspektin metodologjik vëzhguesit e KShH-së morën takim me stafin përgjegjës dhe u njohën me dokumentacionin e vënë në dispozicion prej tyre. Bashkëbisedimet e realizuara u dokumentuan nëpërmjet formularëve të kategorizuar për secilin aktor, pjesë e zinxhirit të ofrimit të ndihmës juridike parësore. Korrespondencat zyrtare të shkëmbyera me këto institucione kanë ofruar një pjesë të konsiderueshme të informacionit statistikor dhe cilësor. **KShH vlerëson bashkëpunimin e shfaqur nga përfaqësuesit e këtyre aktorëve me të cilët u morën takime dhe nxit përshpejtimin e hapave me qëllim ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore ndaj qytetarëve, në mënyrë efikase dhe brenda afateve të arsyeshme.**

¹ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf

² <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim--Komiteti-Shqiptar-i-Helsinkit.pdf>

³ Neni 12 i ligjit nr. 111/2017.

Gjatë këtyre proceseve monitoruese, KShH konstaton se ngritja me vonesë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (pranë Ministrisë së Drejtësisë) nuk ka mundësuar realizimin tërësor të gjitha detyrimeve që i ngarkon ligji kësaj njësie. Konstatohet se miratimi i organikës së kësaj Drejtorie dhe plotësimi i vakancave është miratuar më vonesë përtej afatit të parashikuar nga dispozitat kalimtare në nenin 36 që parashikojnë ngritjen e njësisë brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Konkretisht miratimi i strukturës dhe organikës së kësaj Drejtorie është realizuar me 10 muaj vonesë, ndërkohë që procesi i emërimit nëpërmjet lëvizjes paralele të 2 specialistëve të parë rezultoi i realizuar pas 1 viti e 2 muaj vonesë. Rezultoi se pavarësisht miratimit të strukturës organike në muajin Mars 2019,⁴ Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka filluar funksionimin e pjesshëm në muajin gusht 2019,⁵ ndërkohë që aktualisht janë plotësuar vakancat për nivelin e specialistëve, por niveli drejtues i kësaj Drejtorie nuk rezultoi të jetë rekrutuar dhe emëruar. Ndonëse janë hapur thirrjet nga ana e Departamentit të Administratës Publike për lëvizje paralele me ngritje në detyrë, ende nuk është plotësuar pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike dhe është kërkuar që procedura të vijojë me hapjen e thirrjes për pranim nga jashtë shërbimit civil.

Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga ana e Qendrave të organizuara si njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të këtyre shërbimeve është një kërkesë themelore e ligjit. Aktualisht rezultojnë të ngritura Qendrat në Tiranë dhe në Elbasan, të mbështetura financiarisht nga OSFA. Gjithashtu, me mbështetje financiare nga ana e donatorëve rezultojnë të jenë ngritur Qendrat në qytetet Fier, Durrës, Shkodër dhe Peshkopi. Këto qendra financohen nga ana e UNDP. **Vonesat në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas kanë ndikuar në mirëfunksionimin e DNJF-së. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas referon se emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF-së është një proces shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm për mirëfunksionimin e Drejtorisë, por megjithatë kjo strukturë ka është drejtuar me komandim nga nëpunësi civil më i vjetër në eksperiencë në këtë drejtori prej Marsit të vitit 2019. KShH vëren se, duke patur në konsideratë që DNJF ka kompetenca të rëndësishme në drejtim të administrimit dhe mbikqyrjes së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike, vonesat në emërimin e Drejtorit të kësaj structure kanë ndikuar në menaxhimin dhe drejtimin e Drejtorisë, duke sjellë vonesa në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti nëpërmjet OJF-ve, të cilat kanë vijuar ta ofrojnë këtë shërbim vullnetarisht ose me mbështetje të donatorëve.**

Lidhur me përmbushjen e këtij detyrimi Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në muajin shkurt 2020 ka hapur thirrjen për aplikim me qëllim që organizatat jofitimprurëse të autorizohen nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, pas përfshirjes në një procedurë të përcaktuar konkurrimi. Duhet theksuar se vonesa në miratimin e akteve nënligjore përkatëse për miratimin e kushteve dhe rregullave për zbatimin e dispozitave të ligjit 111/2017 ka bërë që për vitin 2019 të mos ketë një listë të mirëfilltë me organizata të shoqërisë civile të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore në kuptim të ligjit 111/2017.

Gjatë monitorimit të realizuar është marrë takim me 11 përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, duke përfshirë dhe qendrat e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore,

⁴ Urdhër nr. 59, dt. 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, miratuar nga Kryeministri.

⁵ Përkon me datën e emërimit të 2 specialistëve të parë me lëvizje paralele (monitorim dt. 09.03.2020).

të cilat siç u evidentua më lart janë ngritur dhe funksionojnë nën suazën e OJF-ve. Ndihma juridike parësore ofrohet kryesisht nga organizata të shoqërisë civile, nëpërmjet zbatimit të projekteve të ndryshme të financuara nga donatorët. Prej javës së fundit të muajit Mars 2020, shërbimet e ndihmës juridike parësore po ofrohen nga ana e Qendrave të ndihmës juridike parësore (Tiranë dhe Elbasan) si dhe Klinikat e Ligjit të OSFA-s, nëpërmjet platformës elektronike “juristionline.al”⁶. Ndërkohë OJF të tjera të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike si QNLQ, TLAS etj., gjatë periudhës së Covid-19 kanë ofruar asistencë ligjore në rrugë elektronike nëpërmjet faqeve të tyre ëeb dhe rrjeteve sociale.

Është konstatuar se natyra tepër burokratike e dokumentacionit të kërkuar për OJF-të që duan të aplikojnë për të qenë pjesë e ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, i cili është parashikuar në VKM nr. 55, dt. 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, ka vështirësuar së tepërmi punën e tyre. KShH vlerëson se kërkimi i formularit të gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv është një procedurë e cila mund të shmanget, përse kohë që DNJF është strukturë e MD-së dhe mund të ketë akses në dëshmitë e penalitetit që lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Ky ndërveprim ndërinstitucional do të lehtësonte procedurat përkatëse. E njëjta qasje vlerësojmë se mund të zbatohet edhe në kërkimin për lëshimin e vërtetimit nga prokuroria se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike. Kërkesa të tilla për të cilat është e zbatueshme disponimi i një autorizimi apo akt përfaqësimi nga anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës/ekzekutiv e mbingarkojnë funksionimin e OJF-ve që duan të aplikojnë dhe njëherazi të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore, në funksion të interesit publik. Në këtë rast, DNJF mund të vendosë ura bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme, me qëllim kërkimin e informacionit përkatës, pasi është strukturë shtetërore e një institucioni të ekzekutivit që mbulon @ështëjet e drejtësisë.

Qysh në fazën e konsultimit të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 111/2017, KShH ka rekomanduar minimizimin e burokracive për informacione që entet publike/shteti mund t’i sigurojë me iniciativën e tij.

Rol të rëndësishëm në ofrimin e ndihmës juridike parësore e dytësore kanë luajtur Zyra e Ndihmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Klinikat e Ligjit të OSFAs. Ato të ngritura në rrethet Durrës dhe Shkodër, financohen nga Lëviz Albania dhe zbatohen nga OSFA. Nga informacioni shkresor i vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, 7 IAL⁷ kanë shprehur dakordësinë për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit. **Gjatë periudhës që mbulon ky monitorim, u konstatua se ende nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Klinikave të Ligjit të ngritura pranë IAL-ve.** Pas konsultimit të draftit të këtij raporti, përfaqësues të DFNJ-së parashtrajnë prapësimet e tyre për këtë gjetje duke referuar se DFNJ ka lidhur marrëveshje me 8 Institucione të Arsimit të Lartë dhe konkretisht: 1. Fakulteti i Drejtësisë,

⁶ <https://juristionline.al/>

⁷ Përkatësisht Kolegji Universitar “Luarasi”, Kolegji Universitar “Ëisdom”, “Albanian University”, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës; Universiteti “Ismael Qemali” Vlorë; Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe Universiteti European i Tiranës. Burim info: Shkresë nr. 83/1 Prot., dt. 23.03.2020, lëshuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

Universiteti i Tiranës; 2. Kolegji Universitar “Luarasi”; 3. Kolegji Universitar “Ëisdrom”; 4. “Albanian University”; 5. Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës; 6. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë; 7. “Universiteti Europian i Tiranës”. 8. Kolegji Universitar “Bedër”. Mgjth, KShH dëshiron të saktësojë se gjetjet e këtij raporti janë bazuar në korrespondencën zyrtare që kemi patur me Ministrinë e Drejtësisë (shkresa nr.83/1, prot, dt. 23.03.2020 si dhe në monitorimet e kryera në terren, ku vëzhgues të KShH-së kanë ndërmarrë takime me përfaqësues të Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Departamentit të së Drejtës pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Në përfundim të këtyre takimeve është referuar si domosdoshmëri ngritja e Klinikave të Ligjit pranë ambienteve të këtyre universiteteve, me qëllim ofrimin e mundësive për studentët për realizimin e praktikës studimore pranë këtyre njësive.

Në këtë raport të ndërmjetëm, KShH ka evidentuar gjetje dhe rekomandime përkatëse, të cilat reflektojnë situatën e ofrimin të shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga ana e aktorëve përgjegjës në kushte tepër të vështira për stabilitetin e tyre.

1. Ngritja dhe funksionimi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

1.1. Aksesueshmëria dhe kushtet infrastrukturore dhe logjistike të saj

Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, parashikon ngritjen e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas si njësinë përgjegjëse kryesore, e cila menaxhon dhe zbaton ofrimin e ndihmës juridike. Drejtoria funksionon nën varësinë institucionale të Ministrisë së Drejtësisë dhe zyrat e saj janë lokalizuar në katin e gjashtë të Ministrisë së Drejtësisë. **Nga monitorimet e realizuara në terren aksesi i qytetarëve në këtë njësi është i vështirë, pasi nuk ka tabela apo indikacione që të tregojnë vendndodhjen e saj.** Drejtoria është ngritur në zbatim të Urdhërit Nr. 59 datë 25.03.2019 të Kryeministrit, megjithëse konstatohet se ligji Nr. 111/2017 e kushtëzon ngritjen e saj brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit⁸.

Kushtet logjistike të kësaj njësie nuk janë të mjaftueshme për stafin ekzistues të kësaj njësie, me qëllim që ata të përmbushin efektivisht dhe në kushte optimale funksionet e tyre. Fillimisht me ngritjen e kësaj njësie vetëm një zyrë u ishte vënë në dispozicion nëpunësve për realizimin e detyrave të tyre. Aktualisht për shkak të rritjes së numrit të punonjësve, Drejtorisë i janë vënë në dispozicion 2 zyra në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, por pajisjet dhe ambientet nuk rezultojnë të mjaftueshme në raport me stafin (konkretisht janë vendosur 9 specialistë në 1 zyrë). **Vlen të theksohet se ndonëse ngritja dhe funksionimi i kësaj njësie u realizua 10 muaj me vonesë pas hyrjes në fuqi të ligjit, sërish institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masat e nevojshme për ofrimin e kushteve logjistike të përshtatshme për stafin dhe nëpunësit e Drejtorisë, që të mundësojë ofrimin e shërbimit të përshtatshëm për qytetarët.**

⁸ Neni 36 paragrafi 2 i Ligjit Nr.111/2017

Nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas rezultojnë të jenë ngritur 2 grupe. Konkretisht më dt. 05.12.2019, i është dërguar kërkesë Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare. Pas njohjes me propozimin e bërë nga kjo e fundit më dt. 20.12.2019 grupi i punës i ngritur ka realizuar vlerësimin e ambienteve pranë vilave gjermane. Largësia e këtyre ambienteve do e bënte më të vështirë aksesin e qytetarëve, si rrjedhojë ky propozim nuk është pranuar. Më datë 13.01.2020 rezulton të jetë ngritur një tjetër grup pune, i cili ka vlerësuar se ambientet nuk përmbushnin specifikimet teknike të parashikuara. Grupi i punës do të vijojë me kërkimin në terren për ambiente të përshtatshme, ndërkohë që situatë e shkaktuar nga pandemia globale Covid-19 ka shkaktuar pezullimin e këtij procesi për grupin e punës.

Përsa i përket komunikimit me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, aktualisht konstatohet se nuk është ngritur një faqe zyrtare (ëebpage) i këtij institucioni, por nga data 12 Prill 2020 ky institucion komunikon njoftimet e tij në faqen e dedikuar në Facebook “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas”.⁹

1.2. Struktura organizative, procedurat e emërimit dhe vakancat e konstatuara

Organigrama institucionale e miratuar parashikon që kjo njësi të funksionojë me 25 punonjës¹⁰ me një strukturë që përfshin Drejtorin e Përgjithshëm si titullar dhe në përbërje tre drejtori, përkatësisht Drejtoria e zbatimit të politikave dhe administrimit të ndihmës parësore me 5 specialistë; Drejtoria e mbikëqyrjes së standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike me 6 specialistë dhe Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse Aktualisht me 5 specialistë. Aktualisht pranë kësaj Drejtorie ushtrojnë funksionin 12 specialistë. Vendet vakante në funksionet e specialistëve janë plotësuar në masë, ndërkohë që vakanca konstatohen vetëm për pozicionin e specialistit që do të ushtrojë funksionet arkiv, protokoll dhe sekretari. KSHH shfaq shqetësim për vakancat e konstatuara në nivelin drejtues, përkatësisht në këtë Drejtori mungon Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtorët e 3 Drejtorive të sipër cituara.

Në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, procesi i ngritjes së kësaj Drejtorie përfundon në momentin e emërimit të plotë të stafit të parashikuar në organikën e miratuar nëpërmjet Urdhërit të sipër përmendur. Si rrjedhojë, ky proces ende nuk është realizuar.

Përsa i përket vakancës së Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj drejtorie, ky pozicion është shpallur 2 herë nga ana e Departamentit të Administratës Publike (DAP) për lëvizje paralele, por procedura ka përfunduar pa fitues. Së fundmi, në muajin mars nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është dërguar përsëri shkresa për shpalljen e thirrjes nga ana e DAP me propozimin që ky vend vakant të plotësohet me procedurën e konkurimit jashtë shërbimit civil.

1.3. Aktivitetet ndërgjegjësuere të realizuara nga ana e kësaj Drejtorie

Nëpërmjet shkresës nr. 83/1 Prot., dt. 23/02/2020, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas na ka informuar se me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike janë realizuar disa fushata. Për shkak të inagurimit dhe ngritjes së Qendrave së ofrimit të shërbimeve

⁹ <https://www.facebook.com/ndihmejuridikefalas/>

¹⁰ Urdhër nr. 59, dt. 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, miratuar nga Kryeministri.

të ndihmës juridike në qytetet e Elbasanit¹¹, Durrësit¹² dhe Fierit,¹³ konstatohet se aktivitetet ndërgjegjësuere të kësaj Drejtorie janë fokusuar vetëm në këto qytete. Gjithashtu, ka pasur promovim dhe në qytetet Lezhë dhe Kavajë (ky i fundit pranë Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë), por këto qytete nuk janë të përfshira në fushën e zbatimit të këtij projekti. **Gjithashtu, KShH ka konstatuar se gjendja e fatkeqësisë natyrore si pasojë e Covid 19 ka ndikuar në moszbatimin e planit të dedikuar të aktiviteteve ndërgjegjësuere, të hartuar nga ana e DNJF. Nga takimet e realizuara me organizatat në qytetet e tjera të vendit, u reflektua domosdoshmëria e realizimit të tryezave të rrumbullakëta apo vendosjes së urave të komunikimit me përfaqësues të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.**

2. Organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore

2.1. Aksesueshmëria dhe stafi

Në vendin tonë janë të shumta organizatat jofitimprurëse, të cilat për shkak të misionit të tyre kanë ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore përpara hyrjes në fuqi të ligjit në vitin 2018. Gjatë kësaj periudhe 3 mujore, vëzhguesit e KShH-së morën takim me përfaqësues të 11 organizatave jofitimprurëse, duke përfshirë dhe përfaqësuesit e qendrave të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore të ngritura në kuadër të zbatimit të projekteve konkrete nga OJF-të respektive. Këto organizata duke qenë se kanë luajtur një rol aktiv në promovimin dhe forcimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjes sociale të kategorive vulnerabël, përgjithësisht janë të njohura nga ana e qytetarëve të cilët përfshihen në kategorinë e subjekteve përfitues të ndihmës juridike falas.

Vendndodhja e zyrave të tyre është në pika strategjike përgjithësisht në qendrat urbane dhe pranë gjykatave. Disa nga organizatat e monitoruara, prej vitesh i kanë zyrat e tyre në të njëjtin vend çka e bën aksesin për publikun më të lehtë. Vlen të theksohet se organizata të cilat janë themeluar prej një kohë relativisht të gjatë dhe që kanë një fokus të përcaktuar në veprimtarinë e tyre janë lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët. Këto organizata kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve adresa postare, email dhe në disa raste linjë telefonike të dedikuar për të asistuar këdo që ka nevojë për këshillim ligjor.

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se stafi i organizatave jofitimprurëse të përbëhet nga juristë dhe avokatë, të cilët janë të atashuar pranë tyre me kohë të plotë dhe zotërojnë kualifikimet e nevojshme akademike për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore. Gjithashtu, frekuentohen në mënyrë të vazhdueshme nga praktikantë, të cilët janë në përfundim të studimeve universitare, por ofrojnë shërbime të ndihmës juridike falas si paraligjorë me kohë të pjesshme.

¹¹ Inaguruar më dt. 16 Tetor 2019. Më dt. 5 Mars 2020, është realizuar tryezë e rrumbullakët, me përfshirjen e aktorëve të rëndësishëm si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtorja e Policisë Vendore Elbasan dhe përfaqësues të OJF-ve.

¹² Inaguruar më dt. 9 Mars 2020.

¹³ Inaguruar më dt. 27 Shkurt 2020.

2.2. Mënyra e financimit të tyre

Organizatat jofitimprurëse të monitoruara në katër qytetet e vendit, pohojnë se veprimtaria e tyre në kuadër të ofrimit të ndihmës juridike parësore mbështetet financiarisht nga ana e donatorëve, në zbatim të projekteve të ndryshme që kanë në fokus aksesin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Fokusi ku organizatat ofrojnë ndihmë juridike parësore konsiston në çështje të sferës familjare, dhuna në familje, çështje administrative, kujdestari, pension, ose të drejtën për kemp etj. Donatorët kryesorë të cilët kanë mundësuar që këto organizata të mirë-funksionojnë në ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore janë Ambasadat e akredituara në vendin tonë, USAID, UNDP, OSFA, CRD, UNWomen etj.

Vonesa në miratimin e akteve nënligjore me fokus përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionin për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe përpilimin e kontratave tip që duhet të nënshkruhen, të cilat janë analizuar në raportin e mëparshëm të publikuar nga KShH¹⁴, janë pasur me një efekt domino që ka ndikuar në mekanizmin e ofrimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti. Thirrja për hapjen e procedurave për aplikim me qëllim autorizimin e OJF-ve nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, fillimisht është publikuar nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas¹⁵ pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare nr. 6/2020.¹⁶ Përfaqësues të pranishëm të organizatave jofitimprurëse të interesuara si dhe përfaqësues të KShH-së u informuan mbi publikimin e këtij njoftimi në sajë të deklaratës së përfaqësueses të Ministrisë së Drejtësisë në aktivitetin e zhvilluar pranë Fakultetit të Drejtësisë (Universiteti Tiranë) më dt. 25.02.2020.¹⁷ Më dt. 26.02.2020, ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.¹⁸ Publikimi i këtij njoftimi ka respektuar në mënyrë të pjesshme procedurën e përcaktuar në pikën 4 të VKM nr. 55, dt. 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, për shkak se nuk rezulton të jetë krijuar ende faqja zyrtare web e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Deri më tani nuk rezulton të jetë realizuar si procedurë, për shkak se situata e krijuar nga pandemia globale Covid 19 si dhe vështirësisë në sigurimin e dokumentacionit si pasojë e pezullimit të veprimtarisë së gjykatave, detyruan publikimin e njoftimit nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për shtyrjen e afatit të pranimit të aplikimeve.¹⁹ Data 20 qershor 2020 rezulton të jetë afati përfundimtar i vendosur nga ana e MD-së për pranimin e aplikimeve për

¹⁴ <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim--Komiteti-Shqiptar-i-Helsinkit.pdf> (Fq.12)

¹⁵ Njoftim i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas nr. 65, dt. 12.02.2020.

¹⁶ Buletin nr. 6, dt. 24.02.2020. Link: <https://qbz.gov.al/eli/bnjz/2020/6/1f829802-0105-40d0-867e-7dc43a7f20ec>

¹⁷ Në këtë tryezë të rrumbullakët u prezantuan gjetjet dhe konkluzionet e “Monitorimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi: Zhvillimet në lidhje me ndihmën juridike, arsimin juridik dhe edukimin juridik të publikut”, të realizuar në kuadër të projektit të zbatuar nga Fakulteti i Drejtësisë, me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

¹⁸ Link: <http://drejtesia.gov.al/newsroom/njoftime/hapen-procedurat-e-aplikimit-per-autorizimin-e-organizatave-jofitimprurëse-ge-do-te-ofrojne-ndihme-juridike-paresore-te-garantuar-nga-shteti/>

¹⁹ <http://drejtesia.gov.al/newsroom/njoftime/njoftim-per-shtyrjen-e-afatit-te-pranimit-te-aplikimeve-per-dorezimin-e-dokumentacionit-per-aplikim-per-autorizimin-e-organizatave-jofitimprurëse-ge-do-te-ofrojne-ndihme-juridike-paresore-te-gara/>

dorëzimin e dokumentacionit për autorizimin e OJF-ve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti.²⁰

Në sajë të komunikimeve elektronike, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka hartuar dhe disponon një listë me të dhënat e organizatave jofitimprurëse të cilat e kanë në fokus të misionit të tyre ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike. Në kushtet aktuale kjo listë nuk është zyrtare pasi përdoret vetëm për efekt komunikimesh, ndërkohë që të dhënat e pasqyruara në të nuk janë të përditësuara dhe është e nevojshme të rishikohen.

2.3. Marrëdhënia me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas

Në përputhje me parashikimet ligjore, para dhe pas disponimit të autorizimit nga ana e Ministrit të Drejtësisë, organizatat jofitimprurëse të cilat ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore kanë një raport të ngushtë me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.. Drejtoria e Ndhmës Juridike është njësi përgjegjëse që bashkëpunon, ruan marrëdhëniet, lidh kontratat, ushtron veprimtari kontrolli periodik mbi veprimtarinë e organizatave të përzgjedhura për ofrimin e ndihmës juridike.²¹ Roli i kësaj Drejtorie është themeltar pasi shumica e anëtarëve të Komisionit vlerësues përbëhet nga përfaqësues të kësaj Drejtorie.²² Roli i Drejtorisë në marrëdhënie me organizata që ofrojnë ndihmë juridike detajohet në 2 akte të rëndësishme nënligjore, përkatësisht VKM nr.110, datë 06.03.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” dhe VKM nr. 55, datë 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

Një element i rëndësishëm i kësaj marrëdhënie bashkëpunimi, i cili mund të zbatohet në periudhën aktuale kur organizatat jofitimprurëse nuk janë autorizuar, konsiston në realizimin e aktiviteteve në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.²³

Monitorimi i organizatave të ndryshme jofitimprurëse evidentoi disa problematika në aspekt të marrëdhënies ndër institucionale. **Disa organizata u shprehën se nuk janë ftuar për të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga Ministria e Drejtësisë me fokus ndihmën juridike. Problematikë tjetër e ngritur nga ana e organizatave është fakti se, njoftimi mbi hapjen e thirrjes për aplikimin për t’u pajisur me autorizimin e Ministrit të Drejtësisë, i është dërguar me email një numri të kufizuar organizatash, duke cenuar gjithëpërfshirjen. Konkretisht për disa organizata është proceduar me dërgimin e thirrjes me anë të email, kurse disa organizata të tjera kanë marrë njoftimin nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë**

²⁰ Njoftim i dt. 15/05/2020. Link: <http://drejtesia.gov.al/newsroom/uncategorized/per-vendosjen-e-afatit-perfundimtar-te-pranimit-te-aplikimeve-per-dorezimin-e-dokumentacionit-per-autorizimin-e-organizata-ve-jofitimprurëse-qe-do-te-ofro-jne-ndi-2/>

²¹ Neni 7 i ligjit nr. 111/2017.

²² Pika 9, VKM nr. 110/2019.

²³ Neni 8, pika 2, gërma e) i ligjit.

së Drejtësisë. Ka pasur dhe organizata të cilat janë informuar dhe sensibilizuar mbi ekzistencën, procedurat dhe kriteret konkrete të përcaktuara në këtë thirrje, gjatë bashkëbisedimeve me vëzhguesit e KShH-së. Në prapësimet e saj, DFNJ evidenton se është proceduar me njoftimin e organizatave duke zgjedhur disa rrugë, fillimisht duke bërë publikimin në Buletin e Njoftimeve Zyrtare dhe më pas duke ja dërguar thirrjen organizatave të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC). Por KShH vëren se referimi tek faqja e AMSHC-së e kufizon listën e organizatave që marrin njoftimin pasi ka shumë organizata që kanë konflikt interesi për të aplikuar për fonde shtetërore që jepen nga AMSHC apo të cilat nuk kanë interes për të aplikuar tek këto fonde.

Përsa i përket pajisjes me autorizim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, përsa kohë që thirrja për pranimin e aplikimeve nuk ka përfunduar, ende nuk kemi një listë të plotë me organizatat fituese që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore dhe do të mbështeten financiarisht nga buxheti i shtetit. Organizatat jofitimprurëse me të cilat u ndërmorën takime shprehën domosdoshmërinë e forcimit të bashkëpunimit midis Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe shoqërisë civile. Vonesa prej rreth 7 muaj i publikimit të thirrjes për aplikime me qëllim pajisjen me autorizim të organizatave jofitimprurëse, nga momenti i rekrutimit të 2 specialistëve të parë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike, nuk bazohet në asnjë justifikim të argumentuar. Në respektim të parashikimeve ligjore në VKM nr. 110, dt. 06.03.2019,²⁴ në aspektin e kuotave përkatëse të nevojshme për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe atij ankimor, procedura e shpalljes së thirrjes mund të iniciohej që në momentin e emërimit të 4 përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Kjo vonesë ka krijuar ngërçe në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga ana e organizatave jofitimprurëse të cilat përballesh me mungesën e stabilitetit financiar, për shkak të ndryshimit të prioritetëve të donatorëve vendas dhe ndërkombëtar, të cilët jo gjithmonë kanë në fokus ndihmën juridike.

Përfaqësuesit e OJF-ve me të cilat u mor kontakt shfaqën shqetësim lidhur me burokracitë e hasura në zbatim të VKM nr. 55/2019, në të cilat u përcaktua dokumentacioni i nevojshëm që duhet të depozitohet në OJF-ja me qëllim pajisjen me autorizimin e sipërcituar. KShH vlerëson se kërkimi i formularit të gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv është një procedurë e cila mund të shmanget, përsa kohë që DNJF është strukturë e MD-së dhe mund të ketë akses në dëshmitë e penalitetit që lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Ky ndërveprim ndër-institucional do të lehtësonte procedurat përkatëse. E njëjta qasje vlerësojmë se mund të zbatohet edhe në kërkimin për lëshimin e vërtetimit nga prokuroria se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike. Kërkesa të tilla për të cilat është e zbatueshme disponimi i një autorizimi apo akt përfaqësimi nga anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës/ekzekutiv e mbingarkojnë funksionimin e OJF-ve që duan të aplikojnë dhe njëherazi të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore, në funksion të interesit publik. Në këtë rast, DNJF mund të vendosë ura bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme, me qëllim kërkimin e informacionit përkatës, pasi është strukturë shtetërore e një institucioni të ekzekutivit që mbulon @ështëjet e drejtësisë.

²⁴ Pikat 9 dhe 10 të VKM.

2.4. Ngritja e qendrave për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore

Ligjvënësi ka parashikuar në dispozitat e ligjit nr.111/2017 krijimin e qendrave që do të mundësojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas pranë gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme. Këto qendra sipas nenit 8 pika gj) të ligjit administrohen nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike. Ligji parashikon ngritjen e tyre brenda 3 muajve nga ngritja e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Nëpërmjet shkresës zyrtare nr. 83/1 prot., dt. 23/02/2020, të adresuar nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas jemi informuar se (citojmë): *“qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore funksionale në Republikën e Shqipërisë të cilët administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, janë qendra e Elbasanit dhe ajo e Tiranës. Në qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Tiranë ushtrojnë funksionin 3 juristë me trajnim të posaçëm, ndërsa në qendrën e Elbasanit ushtrojnë funksionin 2 juristë”*. Nga monitorimi i realizuar në terren²⁵ pranë Zyrës së Ndihmës Juridike Falas (pranë Ministrisë së Drejtësisë) u informuam se kjo zyrë ende nuk kishte realizuar ndryshimin e statusit të saj si qendër në kuptim të ligjit nr. 111/2017. Kjo zyrë rezulton të ketë ndryshuar statusin e saj duke u shndërruar në Qendër të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, më dt. 4 Maj 2020. Pranë kësaj Qendre ushtrojnë funksionin 2 punonjës.

Qendra e Ndihmës Ligjore Parësore pranë ambienteve të Bashkisë Elbasan u inaugurua më dt. 16 Tetor 2019. Funksionaliteti i saj u garantua në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (OSFA), Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkisë Elbasan. Gjatë këtyre misionëve monitoruese nuk u bë i mundur monitorimi fizik i kësaj qendre, ndërkohë që jemi të informuar se mbështetja financiare e saj nuk është e garantuar nga ana e buxhetit shtetëror, por rrjedh si pasojë e alokimit të fondit përkatës nga ana e OSFA (donator vendas) dhe të menaxhuar e administruar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. **Në planin 6 muor të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ndër të tjera është prioritetizuar hapja e qendrës së ofrimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e Lushnjës dhe Kukësit (me buxhetin e shtetit). Aktualisht rezulton se Drejtoria është në procedura e sipër, sa i përket administrimit të ambienteve pranë Bashkisë Lushnjë dhe Kukës.**

Gjithashtu, më dt. 06/01/2020 me mbështetjen financiare të UNDP, në kuadër të zbatimit të projektit nga QNLQ, është rivitalizuar qendra për ofrimin e ndihmës juridike në ambientet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Marrëdhënia e bashkëpunimit të kësaj qendre me Ministrinë e Drejtësisë, konsiston vetëm në përdorimin e ambienteve të Gjykatës për ushtrimin e funksioneve të stafit të kësaj qendre. Shembulli i kësaj qendre është zbatuar në qytetin e Shkodrës e cila ka filluar veprimtarinë që prej fillimit të vitit 2019, megjithatë për një periudhë kohe nuk ka funksionuar dhe është rivitalizuar nga donatori për të funksionuar deri në muajin Shtator 2020. Qëllimi dhe misioni i Qendrës është ofrimi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore falas për qytetarët në rrethin e Shkodrës. Stafi i kësaj të fundit përbëhet nga 2 persona, një avokat, i cili ofron ndihmën juridike parësore dhe dytësore, si dhe një koordinatorë, e cila ofron ndihmën juridike parësore. Pranë këtyre qendrave atashohen në bazë të nevojave praktikantë dhe studentë të cilët zhvillojnë praktin mësimore.

Përsa më sipër, financimi i qendrave të rivitalizuara në qytetet Shkodër dhe Durrës, realizohet vetëm në kuadër të projektit të zbatuar nga QNLQ, çka ndikonte edhe në qëndrueshmërinë e saj.

²⁵ Dt. 09.03.2020.

2.5. Zyra e Ndhmës Ligjore Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë

Nga data 4 Maj 2020, stafi i kësaj zyre rezulton që të ketë nënshkruar një kontratë pune me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, sipas procedurave të Kodit të Punës dhe parashikimit ligjor të përcaktuar në nenin 8, pika 1 të ligjit nr. 111/2017. Lidhur me mënyrën e veprimit për plotësimin e formularëve dhe regjistrimit të të dhënave për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, rezulton se nga ana e stafit të kësaj zyre më parë janë përdorur formularët e hartuar nga ana e OSFA-s dhe të dhënat hidhen në mënyrë periodike në databazën elektronike të krijuar. Përfaqësuesit e kësaj zyre na bënë me dije se pas ndryshimit të statusit ligjor, është mundësuar plotësimi i formularëve të miratuar dhe të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. **Krahas mungesës së sensibilizimit të mjaftueshëm të qytetarëve rreth parashikimeve ligjore në fuqi dhe domosdoshmërisë së ndërmarrjes së aktiviteteve me fokus ndërgjegjësimin e edukimin ligjor të publikut, përfaqësuesit e kësaj zyre të cilët trajtojnë një numër të konsiderueshëm rastesh ngrenë shqetësimin se dokumentacioni mbështetës i cili duhet të plotësohet nga ana e qytetarit me qëllim përfitimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, është voluminoz dhe i njëjtë me atë që nevojitet për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.** Ndër prapësimet e DFNJ-së lidhur me këtë gjetje të raportit evidentohet edhe fakti i ndikimit të situatës së Covid-19 në pezullimin e këtyre aktiviteteve si dhe ekzistenca e një kalendarit të detajuar aktiviteteve, i cili në fakt nuk është sjellë në vëmendje të KShH-së gjatë korrespondencës zyrtare për kërkimin e informacionit. KShH vëren gjithashtu se mungesa e balancimit proporcional ndërmjet këtyre formave të shërbimeve të ndihmës juridike paraqitet si një pengesë, e cila mund të sjellë hezitimin e qytetarëve për të aksesuar në mënyrë efektive në sistemin e drejtësisë.

3. Klinikat e Ligjit të ngritura dhe të mbështetura financiarisht nga OSFA

3.1. Aksesueshmëria dhe stafi

Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” në kuadër të veprimtarisë tij për forcimin e shtetit të së drejtës ka dhënë kontributin e tij në hapjen dhe rivitalizimin e klinikave të ligjit në qytetet Shkodër dhe Durrës. Këto klinika janë ngritur në kuadër të projektit të zbatuar nga OSFA, nëpërmjet Lëviz Albania, me mbështetjen financiare të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri. Rekrutimi i stafeve të këtyre klinikave realizohet nëpërmjet një procesi intervistimi nga ana e donatorit, OSFA.

Këto Klinika kanë si qëllim ofrimin e asistencës ligjore, në formën e ndihmës juridike parësore dhe dytësore ndaj qytetarëve. Klinika e Ligjit në qytetin e Shkodrës është lehtësisht e aksesueshme për qytetarët pasi ndodhet në një ndër zonat më të frekuentuara të qytetit të pedonale së qytetit të Shkodrës. Stafi i kësaj klinike përbëhet nga 2 persona me profesion avokat, të cilët ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore falas për qytetarët e qytetit të Shkodrës. Deri në muajin Dhjetor 2019 stafi ka patur në përbërje edhe 1 paraligjor, por aktualisht nuk ka një pozicion të tillë në Klinikë.

Ndërsa stafi i Klinikës së Ligjit të ngritura pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” në qytetin e Durrësit përbëhet nga 1 avokate, 1 juriste dhe nga koordinatori i Klinikës, që është dekani i Universitetit. Pranë Klinikës janë angazhuar gjithashtu një numër i caktuar studentësh për një periudhë 1 vjacare, e cila përkon me vitin shkollor akademik.

3.2. Marrëdhënia me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas

Gjatë periudhës së monitorimit,sa i takon bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, përfaqësuesit e këtyre klinikave kanë pohuar se nuk kanë pasur asnjë kontakt dhe nuk kanë marrë pjesë në asnjë aktivitet të realizuar nga kjo Drejtori apo nga Ministria e Drejtësisë, me fokus ndihmën juridike. Ndërkohë përse i përket Klinikës së Ligjit në qytetin e Durrësit, duke qenë se kjo klinikë është vendosur në ambientet e IAL-së, në përputhje me nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, në dhjetor të vitit 2019 nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është dërguar draft marrëveshja e bashkëpunimit. Stafi i kësaj Klinike e ka studiuar dhe ka paraqitur sugjerimet dhe mendimet konkrete pranë koordinatorit të Klinikës, konkretisht Dekanit të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike.

3.2.1. Paqartësi, mendime dhe sugjerime mbi Draft-Marrëveshjen e adresuar

Nga takimet e realizuara në terren me përfaqësues të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Klinikave të Ligjit, vëzhguesit e KShH-së kanë vërejtur mungesë të sensibilizimit dhe përcaktimit të qartë të mënyrës së financimit të këtyre klinikave, në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje. Nga ana e specialistes së komanduar në funksionin e Drejtores së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është pohuar se këto klinika nuk do të mbështeten financiarisht nga ana e buxhetit të shtetëror. Në përputhje me parashikimet ligjore, ky bashkëpunim do të ketë në fokus vetëm trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

Detyrueshmëria për dërgimin e të dhënave statistikore mujore pranë Ministrisë së Drejtësisë nuk është mbështetur në argumenta të mirëfilltë referues, duke krijuar një paqartësi për përfaqësuesit e Klinikave të Ligjit. **Përse kohë që MD nuk ofron mbështetje financiare për mënyrën e funksionimit të Klinikës, mbetet e paqartë baza e këtij detyrimi të vendosur.** Roli i MD vetëm në përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, konsiston në një rol pasiv. Gjithashtu, nga përfaqësuesit e Klinikave të Ligjit është sugjeruar angazhimi i MD për të krijuar rrjetin e Klinikave të Ligjit duke ndihmuar në përcjelljen e eksperiencave më të mira, nëpërmjet organizimit të takimeve të përvitshme.

3.3. Problematikat e Klinikave të Ligjit në universitete

Ligji Nr. 111/2017 parashikon në nenin 13 si aktorë të rëndësishëm të ofrimit të ndihmës juridike parësore edhe klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Nga monitorimi i realizuar në disa nga Klinikat e Ligjit të ngritura pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, konstatohet se këto Klinika nuk janë të parashikuara në statutet e Universiteteve respektive. Përfaqësuesit e Klinikës së Ligjit pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” në qytetin e Durrësit, e kanë parashikuar në prioritetet e tyre që t’i propozojnë Senatit të Universitetit bërjen e Klinikës së Ligjit pjesë funksionale të tij. Fakulteti i Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës, është i vetmi IAL publik që e ka përfshirë Klinikën e Ligjit si një prej lëndëve të kurrikulës arsimore.

Klinikat e mbështetura financiarisht nga OSFA ofrojnë jo vetëm ndihmë juridike parësore, por dhe ndihmë juridike dytësore përsa i përket çështjeve të litigimit strategjik. Stafit që ofron ndihmë juridike parësore duhet të trajnohet në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, por nga monitorimi i veprimtarisë dhe funksionalitetit të klinikave është konstatuar që ato nuk kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara dhe nuk kanë informacion nëse janë zhvilluar sesione trajnime apo nëse është miratuar një modul i posaçëm në bazë të së cilit do të realizohet ky trajnim.

Mospërfshirja në statutin e Universiteve të klinikave të ligjit si pjesë integrale e Institucioneve të Arsimit të Lartë lidhur me statusin juridik të klinikaveka krijuar pengesa. Avokatët e atashuar pranë këtyre Klinikave, të cilët ofrojnë ndihmë juridike dytësore në rastet e litigimit strategjik, përfaqësojnë interesat e kategorive vulnerabel nëpërmjet përdorimit të numrit të licensës personale, por në rast se avokati largohet nga klinika, qytetarët janë të detyruar të rishikojnë dokumentacionin e përfaqësimit në gjykatë.

Vëzhguesit e KSHH-së e panë të domosdoshme ndërmarrjen e takimit me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës. Nga ana e përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas na është vënë në dispozicion shkresa “kthim përgjigje” nr. 4091/1 prot., dt. 02/12/2019, adresuar nga ana e Rektorit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” nëpërmjet të cilës citohet se: *“Ju sqarojmë se, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, nuk ka të krijuar akoma në strukturë ‘klinikë ligjore’, ndaj dhe nuk mund të shprehemi në lidhje me draft-marrëveshjen deri në një moment të dytë atë të krijimit të klinikës ligjore pranë USH-së dhe përcaktimit të personit, i cili do ndjekë dhe do jetë personi kontakti”*.

Në harresë të autoriteteve kyçe pjesë e mekanizmit të ofrimit të ndihmës juridike parësore rezulton të jetë lënë edhe Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në qytetin e Elbasanit. Prej vitit 2012, në këtë fakultet ka filluar veprimtarinë e tij, konform normativës në fuqi, Departamenti i së Drejtës/Drejtesisë, me degët “Shkenca Juridike” me dy profile dhe konkretisht “Shkenca Juridike në Sektorin Publik” dhe “Shkenca Juridike në Biznes”. Në kuadër të nismës për njehsimin e programeve studimore, që ofrohen në fushën e studimit “Drejtësi”, nismë kjo e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me aktin nr. 9939 Prot. datë 03.10.2017, me anë të të cilit ftohen për dhënie mendimi 12 (dymbëdhjetë) Institucione të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat, me shqetësim konstatohet se përfaqësuesit e këtij universiteti nuk ka qenë të ftuar për të qenë pjesë e kësaj nisme tejet të rëndësishme lidhur me qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e një profili shumë të rëndësishëm siç është programi i studimit “Drejtësi”. Departamenti i së Drejtës/Drejtesisë administron njëkohësisht edhe degën e integruar Ekonomia dhe e Drejta, (adoptuar sipas modelit të Departamentit të Shkencave juridike të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Bolonjës), e cila ka funksionuar suksesshem nga viti 2005 me ciklet e studimit Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave. Në këtë departament zhvillojnë jetën akademike dhe shkencore 9 (nëntë) anëtarë me kohë të plotë prej të cilëve 2 (dy) Profesorë të Asociuar, 5 (pesë) Doktorë Shkencash dhe 2 (dy) anëtarë të tjerë në prag të graduimit me gradën Doktor Shkencash, me eksperiencë akademike dhe kërkimore shkencore ndërkombëtare.

Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se në këto dy universitete komunikimet me palët e treta zhvilloheshin në nivel rektorati, e si rrjedhojë dekanati luan një rol sekondar që konsiston vetëm në rishikimin apo dhënien e mendimeve konkrete. Pavarësisht ekzistencës së Klinikës së Ligjit të mbështetur financiarisht nga Lëviz Albania në kuadër të projektit të zbatuar nga OSFA (në qytetin e Shkodrës) dhe Qendrës për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore (në qytetin e Elbasanit), përfaqësuesit e universiteteve respektive në universitetet publike të këtyre rrethëve e referojnë si domosdoshmëri ngritjen e klinikave të ligjit në ambientet e tyre, në përputhje me parashikimet ligjore.

KShH vlerëson se krijimi i këtyre klinikave, i mbështetur nga stafi i kualifikuar i departamenteve përkatëse të së drejtës, është një domosdoshmëri për aftësimin në praktikë të studentëve të dhe për ofrimin e edukimit ligjor dhe ndihmës juridike falas për qytetarët dhe komunitetet në nevojë. Në mënyrë të veçantë, përsa i përket Departamentit të së Drejtës në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” funksionimi i Klinikës Ligjore do të mundësonte që studentëve të aftësuar në praktikë pranë saj t’u njihen kreditet e lëndës “praktikë profesionale” një aktivitet plotësues integrues idetyrueshëm përsa pasqyrohet dhe në planet mësimore të ciklit të dytë të studimeve në degën Ekonomia dhe e Drejta dhe Shkencat Juridike.

4 Sfidat e krijuara nga situata Covid-19

Aktorët që luajnë një rol kyç në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, si Qendrat, Klinikat e Ligjit dhe organizatat jofitimprurëse kanë përdorur forma inovative teknologjike, me qëllim përshtatjen ndaj situatës Covid-19. Masat e marra nga ana e Qeverisë shqiptare detyruan mbylljen e ambienteve fizike të këtyre organizmave, duke bërë që punonjësit e tyre të ushtrorjnë funksionin online, me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi për grupet e cënueshme. Bazuar në të dhënat statistikore të bëra publike në rrjetet sociale nga vetë këto organizma, u vërejt një rritje e numrit të qytetarëve të cilët kërkuan ndihmë ligjore.

Klinikat e Ligjit të OSFA-s të ngritura në qytetet Shkodër, Durrës dhe Vlorë, si dhe 2 Qendrat e MD-së funksionale në Tiranë dhe Elbasan, kanë ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore nëpërmjet platformës “*juristionline.al*”²⁶. Kjo platformë e ngritur në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe OSFA-s, bëri bashkë 12 juristë, të gatshëm për të këshilluar dhe informuar qytetarët lidhur me gjithë legjislacionin e miratuar në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Organizatat jofitimprurëse në vendin tonë, të cilat kanë si pjesë të aktivitetit të tyre ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore kanë përdorur rrjetet e tyre sociale, si Facebook apo ëebpage, me qëllim informimin e qytetarëve dhe sensibilizimin mbi masat e miratuara nga ana e Qeverisë. Gjithashtu, këto organizata kanë bërë publike adresat dhe numrat e kontaktit të personave përgjegjës, pjesë e stafit të tyre, për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore.

²⁶ <https://juristionline.al/>

Leksione të hapura online dhe publikim i fletëpalosjeve elektronike me natyrë sensibilizuese janë realizuar nga ana e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve private dhe atyre publike.

Duke marrë në konsideratë gjendjen e krijuar si pasojë e Covid-19 dhe masat e marra nga ana e autoriteteve publike, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas i është drejtuar në mënyrë të përsëritur Departamentit të Administratës Publike (DAP) dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim marrjen e masave për zhvillimin e trajnimit për punonjësit me trajnim të posaçëm. Konkretisht, me shkresën me nr. 151 prot., datë 08.05.2020, DNJF i është drejtuar DAP dhe ASPA me qëllim bashkëpunimin për mundësimin e ktyre trajnimeve edhe nëpërmjet ëëbinareve. Gjithashtu, DNJF i është ndrejtuar edhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë (DhASh) lidhur me hartimin e kurrikulave për trajnimet e avokatëve sa i përket ofrimit të ndihmës juridike për kategoritë vulnerabël që parashikon ligji. Nga ana e këtyre institucioneve konstatohet se nuk ka pasur ende një përgjigje.

Rekomandime:

Miratimi i ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” përbën një hap të rëndësishëm progresiv ndaj mundësisë që kanë përfaqësuesit e kategorive vulnerabël për të përfituar shërbime të ndihmës ligjore parësore falas. Megjithatë, zbatimi i deritanishëm i ligjit nr. 111/2017 dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatim të tij kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Në këtë kuadër, KShH rekomandon dhe sugjeron:

- 1) Nxitjen dhe përshpejtimin e procedurave në mënyrë që organika e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, pranë Ministrisë së Drejtësisë të plotësohet me funksionarët në nivel drejtues, me qëllim mundësimin e funksionalitetit të plotë të saj.
- 2) Me rikthimin e situatës në kushte normale, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të marrë masa, me qëllim përfundimin e procesit të përzgjedhjes dhe lidhjes së kontratave të shërbimit për ofrimin e ndihmës juridike falas me organizatat jofitimprurëse. Vonesat në finalizimin e këtij procesi të rëndësishëm kanë krijuar problematika në zbatimin e ligjit dhe ofrimin e ndihmës juridike parësore, me mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit.
- 3) Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të marrë masa konkrete dhe efektive për zbatimin e planit 6 mujor të hartuar prej tyre për vitin 2020, me synim ngritjen e qendrave të ofrimit të ndihmës juridike parësore në qytetet Lushnjë dhe Kukës.
- 4) Përballë nevojës për sensibilizimin e qytetarëve ndaj kuadrit ligjor në fuqi dhe rrugëve që duhet të ndjekin për zgjidhjen e problematikave ligjore konkrete, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të bashkëpunojë në mënyrë proaktive me organizatat ndërkombëtare, klinikat e ligjit, dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor në një masë të gjerë të popullsisë, duke mos u kufizuar vetëm në një qytet të caktuar. Sugjerojmë ndërmarrjen e alternativave inovative për përmbushjen e këtij rekomandimi, si vendosja e materialeve promovuese pranë zyrave që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta, stacioneve të mjeteve të qarkullimit urban

dhe interurban; realizimi i fushatave informuese online; përdorimi i flyers dhe shpërndarja e tyre në rrjetet sociale etj.

- 5) Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të stafëve të qendrave për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, duhet të merren masa konkrete që pavarësisht ekspertizës dhe profesionalizmit të punonjësve ekzistues, të realizohet përfshirja e tyre në trajnimin e posaçëm dhe fillestar me qëllim garantimin e respektimit të parimeve të ligjshmërisë, meritokracisë dhe paanshmërisë.
- 6) Krijimin e një hartëzimi me të dhëna të përditësuara të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore, vendosjen e urave të bashkëpunimit me OJF të krijuar në vitet e fundit dhe rritjen e bashkëpunimit e ndërveprimit me to, me qëllim zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut. Ky hartëzim do të garantonte gjithëpërfshirjen dhe do të shmangë përcjelljen e komunikimeve zyrtare dhe të rëndësishme nga ana e autoritete publike, nëpërmjet përzgjedhjes selektive. Eksperienca e organizatave jofitimprurëse është e vyer në krijimin e politikave të përshtatshme për ofrimin e ndihmës juridike të orientuar sipas nevojave dhe fushave specifike që qytetarët kanë nevojë.
- 7) Të nxitet vendosja e urave të bashkëpunimit dhe të nxitet krijimi i tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të Klinikave të Ligjit funksionale pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë publike dhe private, të cilat ndeshen me vështirësi objektive dhe janë udhërrëfyes të mirë të praktikave konkrete pozitive me fokus ndihmën juridike. Të merren hapat konkretë për përfshirjen në diskutime të përfaqësuesve të universiteteve të cilat ende nuk kanë ngritur klinikat e ligjit pranë ambienteve të tyre, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve optimale për përfshirjen e kësaj Klinike në statutin e IAL-së ose si një modul mësimor që shërben për përfitimin e kreditove nga ana e studentëve që e ndjekin.